

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË PODUJEVË -
Departamenti i përgjithshëm – divizioni civil : me gjyqtarin Bujar Muzaqi, dhe sekretaren juridike Afërdita Ejupi, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit NP Ihk "I." sh.a. me seli në F. K., kundër te paditurit A. K. me vendbanim në Rrugën "..." parku i M., Komuna e P., për lirim të palujtshmërisë, më datë 13.05.2016, mbajti seancën kryesore në prezencën të Përfaqësuesit të autorizuar të Paditësit A.E., dhe të njëjtën ditë mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit NP Ihk "I." sh.a. me seli në F. K. si e bazuar dhe **DETYROHET** i padituri A. K. me vendbanim në Rrugën "..." parku i M., Komuna e P. që paditësit t'ia lirojë dhe dorëzoj në posedim pjesën e ngastrës kadastrale nr.2839, vendi i quajtur "Te Hekurudhat", në sipërfaqe prej 0.04.40m², Zona Kadastrale P., pronë e H. e evidentuar në Çertifikatën mbi të drejtat e paluajtshme nr.08/04/714/23754/201 dt. 17.03.2014 si dhe t'ia kompensoi paditësit në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumën prej 30 €uro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kanosje të përmbarimit me dhunë.

Arsyetim

Paditësi më datë 12.06.2003 ka paraqitë padi në Gjykatë për kthimin e patundshmërisë kundër të paditurit N. K. nga P., ku ndër të tjera në këtë padi ka deklaruar se i padituri me vetë dëshirë e ka uzurpuar pjesën kadastrale me një sipërfaqe prej 6 ari.

Më datë 20.03.2014, paditësi ka paraqitë parashtresë në Gjykatë ku e ka bërë precizimin e padisë dhe ndër të tjera ka deklaruar se përgjegjës për shtëpinë e ndërtuar në pronën e uzurpuar të paditësit tani është vëllai i tij A. K..

Gjykata konform kësaj parashtrese ia ka dërguar të paditurit A. K. Aktvendimin C.nr.478/2003 dt 21.05.2015 për përgjigje në padi, si dhe kopjen e parashtresës të dt.20.03.2014.

I Padituri edhe pse e ka pranuar më datë 26.05.2015 aktvendimin për përgjigje në padi, nuk ka paraqitë në Gjykatë përgjigje në padi, dhe i njëjti asnjëherë as në seanca të caktuara në Gjykatë nuk është paraqitur, po ashtu i njëjti asnjëherë nuk ka paraqitë asnjë parashtresë lidhur me padinë e paditësit.

Gjykata në seancën përgatitore të datës 13.05.2016, ka konstatuar se në këtë seancë janë të pranishëm vetëm paditësi, ndërsa i padituri, edhe pse e ka pranuar ftesën në mënyrë të rregullt gjyqësore (Neni 110.2, neni 111.1 të LPK-së) nuk është paraqitur në seancë.

Gjykata, seancën e dt.13.05.2016 e ka mbajtur në mungesë të palës së paditur, në bazë të propozimit të të autorizuarit të palës paditëse, e duke u bazuar që i padituri e ka pranuar ftesën në mënyrë të rregullt Gjyqësore (Neni 110.2, neni 111.1 të LPK-së) edhe mungesën nuk e ka arsyetuar, e duke u bazuar në nenin 409.2 të LPK-së, në të cilin nen ndër të tjera thuhet se **“ Po që se në seancën përgatitore nuk vjen i padituri që është thirrur rregullisht shqyrtimi vazhdon të bëhet me palën paditëse të pranishme”**.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit A. E. në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 13.05.2016 ndër të tjera ka deklaruar se mbetem në tersi pran padis dhe kërkesës së saj, deklaratave të bëra ne seancat e kaluara, parashtresave mbi precizimin e padisë dhe kërkoj që e njëjta te aprovohet si e bazuar, njëherit kërkojmë që i padituri te detyrohet që ne afet prej 30 ditësh që te liroj dhe dorëzoj ne posedim pronën e uzurpuar ne te cilën e ka ndërtuar shtëpinë nga personat dhe gjësendet si dhe te paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë për taksen për padi dhe aktgjykim.

Pas vlerësimit me kujdes dhe me ndërgjegje të secilës provë veç e veç dhe të gjithave bashkërisht e në pajtim me dispozitat e nenit 8 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, Gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është në tersi e bazuar.

Ngase nuk është kontestuese fakti se paditësi në bazë të Certifikatës mbi të drejtat e paluajtshme nr.08/04/714/23754/201 më datë 17.03.2014, ngastra kontestuese nr. 2839, e evidentuar në Zonën Kadastrale P., vendi i quajtur “Te Hekurudhat”, shfrytëzimi aktual tokë ndërtimore - shtëpi, me sipërfaqe prej 0.04.40m² evidentohet në emër të paditësit H. e Kosovës – N.P. Ihk “I.” sh.a me seli në F. K..

Në bazë të aktvendimit nr.15/2000 dt .17.07.2001 të lëshuar nga Unmiku – Kuvendi i Komunës – Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë – P. vërtetohet se paditësi e shfrytëzon pronën shoqërore të ngastrës kadastrale nr. 2839, kultura e pa plleshme, vendi i quajtur “Te Hekurudhat” në sipërfaqe prej 0.04.40m², i njëjti asnjëherë nuk është paraqitur në seanca gjyqësore, po ashtu edhe përgjigje në padi nuk ka paraqitur.

Ne përmbajtje të drejtës pronësore sipas nenit 3 paragrafi 1 të ligjit mbi marrëdhënie themelore pronësore juridike hynë edhe e drejta e dispozitës së nenit 37 par.2 të ligjit mbi marrëdhënie themelore pronësore juridike hynë edhe e drejta e pronarit që “sendin ta mbajë – posedoj”. Andaj në një gjendje të tillë e në kuptim të dispozitës së nenit 37par.2 të ligjit mbi marrëdhënie themelore pronësore juridike në të cilin nen në mënyrë decidive thuhet se “ ***Pronari mund të kërkoj me padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale. Pronari duhet të provoj se mbi sendin kthimin e të cilit e kërkon ka të drejtën e pronësisë dhe se sendi gjendet nën zotërimin faktik të të paditurit e drejta e paraqitjen së padisë nga paragrafi 1 i këtij neni nuk parashkruhet***” u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykim.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore Gjykata u bazua në nenin 452.2 par.2 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore duke e obliguar të paditurin që paditësit t’ia paguaj vetëm pjesën proporcionale dhe të domosdoshme të shpenzimeve procedurale për zhvillimin e procesit gjyqësor dhe atë taksën gjyqësore për padi dhe për aktgjykim në shumë prej 30 Euro.

Prandaj, nisur nga të lartcekurat dhe duke ju referuar nenit/eve 3 par.1, 37 par.2 dhe dispozitave tjera të Ligjit mbi Mardhëniet pronësore juridike dhe konform nenit/eve 4, 5, 7, 8 10, 452 dhe dispozitave tjera të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, dhe konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ

nr.2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË

Departamenti i përgjithshëm- Divizioni Civil

C.nr.478/2003 datë 13.05.2016

Gjyqtari,

Bujar Muzaqi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij Aktgjykimi lejohet ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.